



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 397/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Murat Hoxha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha të subjektit politik LDK në Gjilan, me të cilën pretendohet se në bazë të raportit të vëzhguesit në Qendrën e Votimit (QV) nr. 0408d/03d ka munguar Formulari i Rezultateve të Kandidatëve (FRK) si dhe kanë munguar votat e kandidatit në fjalë gjithsej 59 vota.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka bashkangjitur si provë raportin e vëzhguesve .

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë: *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “*, andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet Murat Hoxha nga subjekti politik LDK, në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e

hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për të cilat kandidati në fjalë pretendon se se nuk ju kanë proceduar 59 votat të tij në FRK nga anëtarët e vendvotimit 0408d/03R.

PZAP-i, ka konstatuar nga FRK-ja origjinale në QNR se kandidati në fjalë i posedon 59 vota dhe së të njëjtat vota PZAP-i, i ka konstatuar edhe nga sistemi i të dhënave në QNR të njëjtat vota kandidatit në fjalë iu kanë publikuar në rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja.

Prandaj pretendimet ankimore se votat në fjalë nuk janë proceduar për tu përfshirë në rezultatin përfundimtar nga parashtuesi i ankesë nuk qëndrojnë ngase hetimet e zhvilluar nga PZAP-i e vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve ankimore.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

Anr. 397/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*